



Emerging Markets

Investors Alliance

Actionable Intelligence for Responsible Investing



Përfitimet e pasqyrave financiare për investitorët dhe agjencitë e vlerësimit kreditor

Fergus McCormick

Aleanca e Investitorëve të Tregjeve të Reja

Programi për Kontabilitetin dhe Raportimin në Sektorin Publik (PULSAR)

Grupi i Bankës Botërore & Qendra për Reformën e Raportimit Financiar

11 nëntor 2020


Objektivat e tregjeve financiare

- Investitorët synojnë të rritin kthimet reale të korigjuara
 - Mbajnë pozicione strategjike ose taktike në bazë të zbulimit të çmimit ose zbulimit të vlerës
- Analistët e vlerësimit kreditor vlerësojnë riskun e kredisë
 - Vlerësohet probabiliteti i moskthimit të borxhit të marrë me obligacione nga një qeveri qendrore apo të përgjithshme
 - Moody's vlerëson edhe humbjen nga moskthimi

Rëndësia e pasqyrës së bilancit për tregjet financiare

- Pasqyrat financiare të bazuara në SNKSP kanë një pasqyrë bilanci – plotëson raportimin tradicional statistikor.
- Pasqyra e bilancit ka rëndësi kritike për të kuptuar:
 - Pikat e forta, pikat e dobëta dhe efektivitetin e një qeverie
 - Sa është transparente dhe sa jep llogari
 - Çfarë prioritetesh ka, sa mirë qeveriset, si i merr vendimet
 - Sa vlerë krijojnë zyrtarët publikë
- Si? Pasqyra e bilancit jep informacion për:
 - Pozicionin financiar, pozicionin fiskal dhe qëndrimin fiskal
 - Strategjinë e borxhit dhe menaxhimin e aktiveve-detyrimeve
 - Bashkërendimin dhe financimin e njësive ekonomike të sektorit publik
 - Fitimet/humbjet e njësive ekonomike nën kontrollin qeverisë
- Pasqyra e bilancit ofron tregues themelorë të domosdoshëm:
 - Teprica e shfrytëzimit përpara fitimeve & humbjeve pasi zbriten shpenzimet nga të ardhurat
 - Borxhi neto
 - Pasuria neto

Shembull i dhënies së informacioneve shpjeguese të plota: Bilanci i Zelandës së Re (viti fiskal i mbyllur në 30 qershor 2019, miliardë NZD)



Raporti pozitiv midis transparencës & ecurisë së tregjeve

- Për një shtet, SNKSP dhe GFS sigurojnë një kuadër standard raportimi. Por shumë pak qeveri e zbatojnë këtë standard. Edhe më pak akoma i përdorin pasqyrat financiare për përgatitjen e buxhetit.
- Përse?
 - Nuk e kanë kapacitetin
 - Nuk ia dinë vlerën
 - Kanë frikë nga pasojat e dhënies së informacioneve
 - Duan të fshehin diçka
 - Përqendrohen te periudha afatshkurtër

Raporti pozitiv midis transparencës & ecurisë së tregjeve

- Nga këndvështrimi i investitorit, kur nuk ka të dhëna të mjaftueshme dhe kur nuk ka transparencë të mirë fiskale, atëherë nuk perceptohet drejt risku dhe vlera shtetërore. Kjo çon në caktimin gabim të çmimit mbi riskun.
- Nga këndvështrimi i analistit vlerësues, mungesa e të dhënave të mjaftueshme dhe e transparencës fiskale në përgjithësi çon në vlerësim më të ulët kreditor të një shteti.
- Mungesa e informacioneve krijon pasiguri, shtrembëron vlerësimet kreditore dhe bën që analistët të mendojnë më të keqen.
- Nga ana tjetër, sa më shumë informacion të bëhet i ditur, aq më i lartë caktohet vlerësimi kreditor dhe aq më i ulët bëhet përqindja e obligacionit.

Transparenca fiskale në rritje është reformë strukturore

- Përmirësimi i dhënies së informacioneve është një reformë strukturore fiskale.
- Investitorët dhe analistët vlerësues i shohin me sy të mirë reformat. Përmirësimi i dhënies së informacioneve konsiderohet si diçka pozitive nga analistët vlerësues dhe investitorët. (Por, kjo ndodh vetëm nëse rritja e transparencës i komunikohet qartë tregut.)
- Me përjashtim të vendeve që janë afër moskthimit të borxhit, kjo do të thotë se përmirësimet graduale në dhënien e informacioneve e përmirësojnë perceptimin për riskun e vendit dhe aftësinë e tij kredimarrëse, edhe nëse informacioni i rrit detyrimet dhe ekspozon menaxhim të dobët.
- Kjo vlen për statistikat ekonomike (GFS) dhe për pasqyrat financiare (SNKSP).

Skeptikët e tregut

- Investitorët dhe analistët vlerësues të cilët nuk ua njohin vlerën pasqyrave financiare apo pasqyrës së bilancit.
 - Investitorët objektivi i vetëm i të cilëve është rritja e kthimeve reale të korigjuara.
 - Analistët vlerësues të cilët e shohin riskun sipas një mënyre ciklike apo vlerësimet e të cilëve ndjekin vlerësimet e agjencive të tjera vlerësuese.
 - Investitorët apo analistët të cilët frenohen nga kufizimet rregullatore, metodike apo nga kapaciteti i brendshëm.

Entuziastët e tregut

- Investitorët apo analistët të cilët
 - Ndjekin një qasje tërësore dhe më afatgjatë lidhur me sektorin e konsoliduar publik.
 - E shohin pasqyrën e bilancit si një instrument për menaxhimin e riskut.
 - Ndjekin dhe vlerësojnë vlerëson e rritjeve shtesë të transparencës fiskale.
 - Monitorojnë komponentin shtetëror në mjedis, shoqëri dhe qeverisje në funksion të integritetit apo të angazhimit.

Rritja e transparencës fiskale mund të rrisë aftësinë kredimarrëse

- Rritja e transparencës fiskale është mënyra më e lehtë dhe më e shpejtë për ta rritur cilësinë kreditore: ofrohet një bilanc me të dhënat ekzistuese, shpjegohen boshllëqet në të dhëna, përmirësohet përgatitja e buxhetit.
 - Përmirësohet vazhdimisht dhënia e të dhënave në kuadër të një sistemi të menaxhimit financiar publik.
- Bëhet paraqitje e thjeshtuar e të dhënave krahas paraqitjes së plotë.
- Komunikohet rregullisht me investitorët, analistët vlerësues.

Faleminderit

- Fergus J. McCormick
- Drejtor i Studimeve Shtetërore
- Aleanca e Investitorëve të Tregjeve të Reja
- Nju Jork, Nju Jork
- +1 (917) 660 4731
- fmccormick@eminvestorsalliance.org